



VENDIM

Nr.89 Datë 26.11.2009

**PËR
FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR LICENSIMIN E SHOQËRISË
“HIDROALBANIA ENERGJI” SH.P.K**

Në mbështetje të neneve 8, pika 2 gërma “a”, nenit 9 dhe 13 pika 1, gërma “a”, të Ligjit nr.9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, nenit 4, pika 1, gërma “a”, dhe nenit 10, pikat 1 dhe 3 të “Rregullores për Proçedurat e Liçensimit, Modifikimit, Transferimit të Plotë/Pjesshëm dhe Rinovimit të Liçensave”, të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr.108, datë 09.09.2008, nenit 18, pika 1, gërma “a”, të Rregullave të Praktikës dhe Proçedurave të ERE-s, miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.21, date 18.03.2009, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 26.11.2009, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “HIDROALBANIA ENERGJI” sh.p.k., për t`u licensuar në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike,

Dhe konstatoi se:

Aplikimi plotëson përgjithësisht kërkesat e ERE-s lidhur me licensimet në sektorin e energjisë elektrike të:

- **Formatit të aplikimit (neni 9, pika 1)**
- **Dokumentacionit juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2)**
- **Dokumentacionit finaciar dhe fiskal (neni 9, pika 3)**
- **Dokumentacionit teknik (neni 9, pika 4)**

Per Dokumentacionin që ka të bëjë me: Miratimin e OST-s ose OSSH-s per lidhjen e centraleve me sistemin elektroenergjetik, aplikuesi është në pritje të miratimit të saj për ta paraqitur më pas në ERE.

Për gjithë sa më sipër Bordi i Komisionerëve të ERE-s,



REPUBLIKA E SHQIPERISE
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISE
Bordi i Komisionereve



Vendosi:

1. Të fillojë procedurat për licensimin e shoqërisë “HIDROALBANIA ENERGJI” sh.p.k, në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-i Borje, HEC-i Orsheke, HEC-i Cernalev dhe HEC-i Cernalev 1.
2. Ngarkohet Drejtorja e Licensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.



Votimi i Bordit të Komisionerëve të ERE-s për,

VENDIM IN

Nr.89 Datë 26.11.2009

**PËR
FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR LICENSIMIN E SHOQËRISË
“HIDROALBANIA ENERGJI” SH.P.K**

Anëtarët e Bordit

	Pro	Kundër
Bujar Nepravishta	_____	_____
Entela Shehaj	_____	_____
Ardian Haçi	_____	_____
Abaz Aliko	_____	_____
Shkelqim Bozgo	_____	_____